



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

partive politike të akredituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, zoti Kaso, zoti Kaziaj, zoti Sulo. Atëherë, mund ta fillojmë mbledhjen. Sikundër është njoftuar ky projektvendim vjen në kuadër të realizimit të disa proceseve që lidhen me identifikimin elektronik të votuesve. Tashmë është bërë i njohur fakti që, Komisioni Rregullator ka miratuar më herët akte lidhur me identifikimin elektronik. Është lidhur kontrata me operatorin që do të ofrojë këtë shërbim dhe vijmë në momentin që duhet të përcaktojmë disa rregulla, disa kritere lidhur me përdorimin e pajisjeve të identifikimit elektronik, të cilat do të vendosen në çdo qendër votimi, për të mundësuar identifikimin elektronik të zgjedhësve. Ky akt në Komisionin Rregullator vjen me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj do ta ftoja Komisionerin të prezantonte aktin dhe relacionin shoqërues të tij. Zoti Celibashi!

**Z.I.Celibashi:** Po! Faleminderit zonja kryetare! Dëgjohem? Faleminderit edhe njëherë! Paraprakisht, dua të them që ky është një akt, i cili edhe në pikëpamje formale në fakt është i bashkëpropozuar me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Është një akt, i cili vjen në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përse i përket implementimit të teknologjisë së informacionit, dhe në mënyrë të veçantë për këtë rast, sistemit dhe pajisjeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve. Neni 23, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton se: Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit në zgjedhje, vihen në përdorim nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveçse kur Rregullatori vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privat të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për përpunimin e shërbimeve. Së bashku me nënkomisioneren kemi konsideruar që zgjidhja më e mirë në raport me kohën, me interesin e palëve pjesëmarrëse në proces të partive politike më së pari, por edhe me kapacitetet financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, menduam që zgjidhja më e mirë do të ishte

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

që këto pajisje, pra pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, të përdorëshin të paktën për këto zgjedhje nga një personel i kualifikuar, i cili do të emërohej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pra, të mos ishin punonjës të cilët do të përzgjidheshin nga kompania që do të ofronte pajisjet, apo dhe nga kompani të tjera, sikurse ligji lejon në këtë rast. Nëpërmjet kriterëve, të cilat ne kemi menduar që duhet të gëzojnë personat, të cilët do të punojnë dhe do të ofrojnë shërbimin për përdorimin e këtyre pajisjeve, kemi menduar që sigurohet integriteti i këtij procesi, pasi është shumë e rëndësishme që të kuptojnë të gjithë që personeli, i cili do të angazhohet me përdorimin e këtyre pajisjeve, të jetë i aftë, nga pikëpamja profesionale dhe pse nuk kërkohen njohuri të thelluara, por kërkohen njohuri bazike nga teknologjia e informacionit dhe nga ana tjetër të jenë sa më të distancuar dhe sa më të larguar, apo barazlarguar, të themi, më mirë, nga forcat politike, dhe të qëndrojnë sa më larg interesit të tyre. Për sa kjo është e mundur nga pikëpamja objektive. Thënë këtë, mendojmë që çfarë është propozuar në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë ky personel, mendoj që e kënaq interesin e partive politike për një garanci në procesin e administrimit të këtij momenti. Nëpërmjet këtij projektakti ne synojmë që më së pari, pjesë të këtij personeli të kualifikuar, të përcaktuar, ose të përkufizuar si i kualifikuar, do të jenë studentët. KQZ, që nga dita e sotme, ose ndoshta nga nesër, do të drejtojë një thirrje të hapur për të gjithë të interesuarit për t'u bërë pjesë e këtij personeli. Mendoj që do të jetë në interes si nga pikëpamja ekonomike, për ata të cilët do të kërkojnë që të angazhohen me këtë shërbim, por edhe nga pikëpamja profesionale dhe e interesit të formimit të tyre profesional. Shpresojmë që do të kemi një përgjigje pozitive nga një shumicë prej 5 mijë, rreth 5 mijë e treqind qytetarë me të drejtë vote, të cilët mund të kenë interesin për t'u angazhuar në këtë projekt të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Celibashi! Atëherë, të nderuar kolegë! Pas prezantimit të projektaktit ju ftoj të votojmë në parim projektaktin. Më së pari u drejtohem anëtarëve të komisionit. Zonja Vukaj!

**Znj.H.Vukaj:** Faleminderit zonja Nano! Përshëndetje të ftuarve dhe kolegëve! Do doja të ndaja një konsideratë vijuese me atë çfarë propozuesi, në këtë rast, Komisioneri parashtroi, e cila ka të bëjë me rëndësinë e aktit që paraqet akti, por dhe me rëndësinë e momentit në të cilin vjen ky akt. Ky është një moment, ku ruajtja e integritetit dhe e pacënueshmërisë së procesit zgjedhor është kaq e mprehtë, siç e dimë, edhe për shkak të risive të imponuara nga ndryshimet e herëpashershme në Kod, dhe gjatë periudhës të shqyrtimit që mori ky akt, dhe me këtë rast dua të përshëndes edhe ju kolegë sepse patët gjithë *buon sens*-in për t'i qëndruar shtyllës tonë të parjes së këtij procesi me objektivitet dhe paanshmëri, kjo e transpozuar dhe në përmbajtje të aktit. Dhe do të thoja që gjatë shqyrtimit në akt, ne u përpoqëm, që edhe pse ky është një akt komplementar, por padiskutim i rëndësishëm për nga ajo që sjell ose çfarë synon të arrihet në funksion të një procesi, tashmë risi për Shqipërinë dhe për procesin zgjedhor, siç është identifikimi përmes PEI, pra pajisjes elektronike të identifikimit dhe mbajtjes larg të këtij, le të them, të këtij segmenti të procesit. Pra të identifikimit të dokumentit të gjithkujt që përbën kategorinë e votuesve nga një kategori tjetër, e cila presupozohet të jetë e paanshme dhe e pandikuar, siç mund të jenë studentët në këtë rast, apo ato që kanë cilësitë e një grupi, e cila nuk është e ndikuar si pjesa e administratës, apo te pjesa e policisë, apo te pjesa e gardës, apo pjesë e disa strukturave të cilat mendohet se kanë, dhe mund të kenë ndikim në procesin zgjedhor. Kjo ishte në drejtim të çfarë do të sjellë akti, shpresojmë që edhe palët të gjejnë dakordësinë me përmbajtjen që kemi shqyrtuar ne dhe ato çfarë kemi sjellë në draftim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Nëse kolegët, anëtarët e tjerë të Komisionit Rregullator kanë diçka për të thënë lidhur me projektaktin, në kuadër të diskutimit në parim? Unë në fakt sikundër Komisioneri e theksoi më herët, ky akt vjen si bashkëpropozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, zonjës Pelinku. Nuk e di, nëse zonja Pelinku, si bashkëpropozuese e këtij akti, ka diçka për të thënë në kuadër të diskutimit në parim? Para se t'ia kaloj fjalën përfaqësuesve të partive politike? Zonja Pelinku?

**Znj.L.Pelinku:** Jo, nuk kam asgjë për të shtuar në raport me çfarë raportoi Komisioneri.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Atëherë, përfaqësuesit e partive politike, zoti Kaso, zoti Kaziaj, zoti Sulo? Nëse keni diçka në parim lidhur me projektaktin para se të kalojmë në botim? Në rregull, faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë! Zoti Sulo, po urdhëro!

**Z.Sh.Sulo:** Faleminderit! Duke respektuar dhe radhën, mendova se përfaqësuesit kishin ndonjë ide. Unë e vlerësoj jashtë mase këtë akt, i cili me një fjalë ka ardhur sot, pasi është një risi *(nuk dëgjohet)* që ndodh në botimet e *(nuk dëgjohet)* vlerësoja duke iu referuar dhe fjalimit që mbajti Komisioneri. Kjo nuk është se është një akt, i cili, apo një veprim që do të kënaqë partitë politike. Kjo do të bëjë të mundur për gjithë mbarë komunitetin shqiptar që të bëhet një votim sa më *(nuk dëgjohet)* Për mua personalisht do të ishte në këtë akt të mos të vlerësoheshin vetëm studentët por dhe personat, që me një fjalë, të kenë mbaruar studimet përsa i përket inxhinierisë elektronike apo *(nuk dëgjohet)* instrument për të bërë një vlerësim sa më saktë të botimit, kjo do ishte *(nuk dëgjohet)* ligjit, që të kënaqen gjithë zgjedhësit shqiptarë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Sulo! Atëherë, kur të vijë momenti i diskutimit nen për nen, nëse duhet të keni ndonjë propozim konkret më lejoni të them paraprakisht, atë që dhe Komisioneri e theksoi. Lidhur me studentët, është një përparësi që u jepet kësaj kategorie, në raport me kategori të tjera, por ndërkohë nuk përjashtohet asnjë nga kategoritë që ju theksuat pak më sipër, pra për të aplikuar për këtë shërbim që do të ofrohet për të asistuar në qendrat e votimit, gjatë ditës së votimit. Atëherë, të nderuar kolegë, ju ftoj që të votojmë në parim projektvendimin.

**Kush është dakord?** Zonja Vukaj nuk është ndoshta në linjë në këtë moment. Ndoshta ka ndonjë problem teknik. Po, atëherë, zonja Vukaj është në linjë dhe po shpreh dakordësinë e saj. Të nderuar kolegë!

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Atëherë, mesa shoh jemi të pestë dakord.

Pra, me pesë vota pro, miratohet në parim, projektvendimi "Për caktimin e personelit të kualifikuar për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrën e votimit".

Atëherë, pasi votuam në parim, fillojmë diskutimin nen për nen. Projektakti ka 12 nene. Më lejoni të lexoj secilin nen sipas radhës. Do të ftoja përfaqësuesit e partive politike, nëse kanë diçka lidhur me nene konkrete, të kërkojnë fjalën. Fillojmë me nenin 1. Neni 1. Qëllimi dhe objekti. Pika 1. Gjithashtu do të kërkoja nga pjesëmarrësit të fikin mikrofonat në momentin që flet dikush, sepse ka një lloj interference. Atëherë!

Neni 1. Pika 1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të pranimit dhe të trajnimit të personelit që do të caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ. Si operator teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

së informacionit për identifikimin elektronik të zgjedhësve në qendrat e votimit.  
QV.

Pika 2. Objekti i këtij vendimi është të përcaktojë:

a. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë shtetasi shqiptar, që caktohet si operator teknik për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve PEI.

b. Procedurat e përzgjedhjes dhe të caktimit të operatorit teknik.

c. Detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit. Kjo është përmbajtja e nenit 1. Atëherë, sipas rregullores më së pari fjalën e kanë përfaqësuesit e partive politike, më tej anëtarët e Komisionit Rregullator. Nëse dëshiron dikush të marr fjalën? Mesa shoh nuk ka komente apo propozime. Atëherë, ftoj anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë nenin 1, sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioneri dhe Nënkomisionerja. Të nderuar kolegë! Votojmë atëherë.

***Kush është dakord me nenin 1?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Atëherë, me pesë vota pro, miratohet neni 1 i projektvendimit.

Neni 2. Papajftueshmëritë me detyrën e operatorit teknik.

Pika 1. Nuk mund të caktohet si operator teknik, shtetasi i cili:

a. Ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonën zgjedhore, ku ndodhet qendra e votimit, në të cilën operatori teknik është caktuar.

b. Është ushtarak, punonjës i strukturave së Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Ministrisë së Brendshme, i Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave dhe shërbimeve të tjera me objekt veprimtarie të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



ngjashme me sa më sipër. Kemi ndonjë koment apo ndonjë propozim për shtesa, ndryshime në këtë nen, lidhur me papajtueshmëritë me detyrën e operatorit teknik? Zoti Kaso, zoti Kaziaj, zoti Sulo?

**Z.Sh.Sulo:** Shumë saktë!

**Znj.I.Nano:** Të nderuar kolegë, mesa shoh, as ju nuk keni ndonjë propozim. Kështu që unë do t'ju ftoja të votojmë nenin 2. Papajtueshmëritë me detyrën e operatorit teknik, sipas propozimit të ardhur.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 2, ju lutem?

Me pesë vota pro, miratohet neni 2 i projektvendimit.

Neni 3. Kushtet për t'u caktuar operator teknik.

Pika 1. Pranimi i operatorëve teknikë bëhet në bazë të parimit të konkurimit të hapur.

Pika 2. Kandidati për operator teknik duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:

- a. Gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës.
- b. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një vepre penale.
- c. Ka të paktën arsim të mesëm.
- ç. Nuk ka qenë pjesë e administratës zgjedhore në dy proceset e fundit zgjedhore.
- d. Nuk është anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën 3 vitet e fundit.
- dh. Nuk ka qenë i përfshirë publikisht në veprimtari dhe aktivitete politike dhe elektorale për llogari të një subjekti zgjedhor në pesë vitet e fundit.
- e. Të ketë njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si kompjuter, *smartphone*, etj.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





ë. Të jetë i gatshëm për të ofruar shërbimin edhe larg vendbanimit. Edhe njëherë u drejtohem përfaqësuesve të partive politike, nëse kanë diçka lidhur me nenin 3. Ndjesë, më duhet të lexoj dhe pikën 3, të këtij neni.

Pika 3. Operatori teknik duhet të jetë me vendbanim në territorin e qarkut, ku ndodhet qendra e votimit, ku ai do të caktohet nga KQZ. Caktimi i operatorit teknik në qendrën përkatëse të votimit bëhet me short mes kandidatëve të përzgjedhur për qarkun përkatës. Ka ndonjë propozim, ndonjë ndërhyrje që e vlerësoni?

**Z.Sh.Sulo:** Po, nëse më lejohet!

**Znj.I.Nano:** Po, zoti Sulo, po, patjetër!

**Z.Sh.Sulo:** Faleminderit zonja kryetare! Në raport me pikën “c”, siç e përmenda edhe pak më parë. Unë do të propozoja që, të paktën të jetë me arsim të lartë dhe të jetë inxhinier elektronik. Meqenëse kemi të bëjmë me një risi, për sa i përket këtij votimi apo dhe pajisjeve që janë, do të kërkoja që të paktën të ketë një farë arsimi të lartë. Pra, pika “c” të bëhet, të paktën të ketë arsim të lartë. Dhe të shtohet: dhe të paktën njohuri mesatare në gjuhën angleze, se besoj që pajisjet do të jenë në gjuhën angleze. Ky do ishte propozimi im.

**Znj.I.Nano:** Në rregull! Atëherë, para se të kalojmë për votim, propozimin e zotit Sulo, në fakt, unë do t’i drejtohesha dy propozuesve, nëse kanë ndonjë vlerësim paraprak. Në fakt, siç është theksuar edhe më herët, përdorimi i pajisjes kërkon një njohuri minimale të përdorimit të pajisjeve elektronike, si kompjutera apo *smartphone*, gjithsesi i nderuar Komisioner, e nderuar zonja Pelinku, Nënkomisionere. Nëse keni diçka për të sqaruar para se të kalojmë në votim, propozimin e zotit Sulo? Po, zoti Celibashi!

**Z.I.Celibashi:** Pajisja do të jetë, gjithë komandat dhe mënyra e përdorimit do të jetë në gjuhën shqipe. Çdo gjë do të jetë e shkruar shqip. Nuk ka asnjë gjë në gjuhë të huaj. Nuk kërkon njohuri të thelluara për teknologjinë e informacionit, Çdokush që di të përdorë, edhe në mënyrë bazike një telefon inteligjent, pra, një *smartphone*, mund të përdorë më lehtësisht akoma këtë pajisje. Nuk është se implikon njohuri të thelluara nga teknologjia e informacionit. Dhe prandaj mendoj që nuk kërkon, nuk është e domosdoshme, që ata të cilët do të operojnë me këtë pajisje të kenë arsim të lartë, e para, dhe më shumë akoma të kenë njohuri nga fusha e teknologjisë së informacionit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj. Iliriana Nano:** Faleminderit zoti Celibashi!

Nëse, ...?! po, zoti Kaziaj, po!

**Zoti Altin Kaziaj:** po zonja Nano. Përshëndetje të gjithëve!

Më shumë kisha një pyetje për komisionerin për sa i përket pikës 2 të nenit 3, që saktësohet të jetë i gatshëm për të ofruar shërbimet larg vendbanimit. Në këtë rast si do të veprohet, si do bëjnë këta shtetas për të votuar? Pra në qoftë se janë larg vendbanimet.

**Znj. Iliriana Nano:** Zoti Kaziaj, po ju përgjigjem unë lidhur me këtë çështje!

Në një nen vijues më poshtë është parashikuar, konkretisht në nenin 11, “votimi i operatoreve teknike”; është parashikuar që operatorët teknikë të votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar për të ofruar shërbimin.

**Zoti Altin Kaziaj:** D.m.th. duhet të ndërpresin procesin e identifikimit biometrik dhe të shkojnë pranë qendrës së tyre të votimit?!

**Znj. Iliriana Nano:** Në qendrën e votimit ku janë caktuar për të ofruar shërbimin si operatorë teknikë; pra njëloj si anëtarët e komisionit të qendrës së votimit.

**Zoti Altin Kaziaj:** Dakord, qartë!

**Znj. Iliriana Nano:** Kështu është parashikuar!

Atëherë jemi tek propozimi i zotit Sulo. Në pikën c zoti Sulo propozon të riformulohet: “të ketë të paktën arsimin e lartë, preferohet arsim i lartë inxhinieri elektronike”; zoti Sulo, a jam korrekt me propozimin tuaj?!

**Zoti Sh. Sulo:** Po zonja kryetare, dakord!

**Znj. Iliriana Nano:** Faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë, votojmë propozimin e zotit Sulo për riformulimin e pikës c të pikës 2, neni 3.

**Kush është dakord me propozimin e zotit Sulo?**

**Pro:** *S'ka*

**Kundra:** *5*

Atëherë me 5 vota kundër nuk miratohet propozimi i zotit Sulo!

Atëherë do të ftoja kolegët të miratojmë në tërësi nenin 3 në kushtet që nuk kemi propozime të tjera; pra, të votojmë nenin 3 sipas përmbajtjes së ardhur nga propozuesit!

**Kush është dakord me nenin 3, ju lutem?!**

**Me 5 vota pro miratohet neni 3 i projektvendimit!**

Neni 4.

Përparësia në përzgjedhje.

Pika 1. Përzgjedhja e operatorëve teknikë për përdorimin e “PEI” do të ndjekë këtë rend përparësie:

- a) Studentët në *mastër*, jo pjesë e administratës publike;
- b) Studentët në *bachelor*, jo pjesë e administratës publike

Pika 2. Nëse numri i operatorëve të kërkuar nuk plotësohet nga kategoritë e mësipërme, KQZ vijon rekrutimin nga kategori të tjera të lejuara sipas këtij vendimi.

Çelimi diskutimin për këtë nen. Përfaqësuesit e partive politike dhe më tej janë anëtarët e rregullatorit; nëse ka ndonjë koment apo rregullim, ose shtesë për ndryshim?!

Mesa shoh nuk kemi komente apo propozime. Kështu që ftoj anëtarët e ...

**Zoti Sh. Sulo:** Zonja kryetare!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



**Znj. Iliriana Nano:** Po, urdhëroni!

**Zoti Sh. Sulo:** Meqenëse jemi në momentin e përzgjedhjes, unë nuk e di se sa i sigurt do të jem unë personalisht, si përfaqësues i një partie politike që një student i zgjedhur nuk mund të jetë anëtar i FRESH-it, apo persona të caktuar nën trysni nga administrata e KQZ-së. Në këto kushte, unë do të propozoja që mund të aplikonte çdo person që mund të kishte të paktën minimalen e njohurive mbi pajisjet elektronike, apo njohurive elektronike për këto pajisje. Kjo do të ishte për mua një propozim i duhur!

**Znj. Iliriana Nano:** Sapo e votuam zoti Sulo!

**Zoti Sh. Sulo:** Sepse, normalisht, këtë grumbull të madh studentësh, ... (shënim: nuk kuptohet asgjë nga ajo çfarë zoti Sulo thotë), ... sepse duhej të flisja paraprakisht, isha përgatitur afër lokalit të institucionit, për të qenë në mbledhje online, por na erdhi njoftimi 10 minuta përpara, që duhet të jemi në këtë komunikim kështu, ... në këto kushte, prandaj do desha që të rregullohej mënyra e aplikimit të këtyre personave që do të aplikojnë. Ky është shqetësimi që kam unë; nuk e di se si e ka zgjidhur komisioneri, pasi një ditë kam qenë aty dhe kam parë nja 50 studentë, nuk e di ndoshta janë thirrur paraprakisht. Faleminderit!

**Znj. Iliriana Nano:** Atëherë, për sa i përket komisionerit do t'ju përgjigjet ai vetë, për sa i përket asaj që ju thatë më herët, lidhur me aftësitë minimale lidhur me përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, ne sapo e votuam në nenin 3 pika e; është në fakt një nga kushtet për tu caktuar operator, ... sapo e votuam, pra kandidati të ketë njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit. Kjo do të thotë që neni vijues, pra

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

neni 4, në fund të fundit vendos një lloj përparësie në përzgjedhje, pra nuk i mohon askujt të drejtën për të aplikuar por gjatë procesit të përzgjedhjes, i cili do të drejtohet nga nënkomisionerja Pelinku, do të kenë përparësi këto kategori. Lidhur me komentimin apo pyetjen që i drejtuat komisionerit, besoj që ai mundet të përgjigjet!

**Zoti Sh. Sulo:** Mundet që në përzgjedhjen e këtyre të ketë aftësi minimale, shpresojmë të mos ketë vetëm ato aftësitë për të përdorur telefonin, për të aplikuar tek ndonjë emision, “përputhen” apo tjetër. Shpresojmë për diçka më tepër se sa këto që të jemi korrekt me mekanizmat apo materialet për të cilat do të bëjnë zgjedhjen. Kjo është pjesë që unë shqetësohem!

**Znj. Iliriana Nano:** Zoti Sulo, do t’ju ftoja të ishit më serioz në komunikim dhe komentet që jepni!

**Zoti Sh. Sulo:** Mirë, faleminderit!

**Znj. Iliriana Nano:** Sigurisht, janë disa aftësi, për të cilat do të ketë një komision, një strukturë përgjegjëse në komisionin qendror të zgjedhjeve; madje do të jetë vetë nënkomisionerja Pelinku që do të drejtojë apo monitorojë gjithë procesin e përzgjedhjes bazuar në këto kushte, kritere dhe procedura që jemi duke diskutuar dhe miratuar.

**Zoti Sh. Sulo:** Unë i drejtohem KQZ-së zonja kryetare!

**Znj. Iliriana Nano:** Mirë, atëherë, të nderuar kolegë keni ndonjë propozim për nenin 4! Nëse jo, ju ftojme të kalojmë në votim nenin 4, “Përparësia në përzgjedhje”.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 4?

Zoti Çakaj për momentin duket se nuk është në linjë; janë problematika që vijnë si rezultat i mbledhjes *online*.

Nëse është e mundur nga administrata e KQZ-së të kontaktojnë me zotin Çakaj, ju lutem!

Në çdo rast me 4 vota pro neni miratohet, por na duhet edhe vullneti i shprehur i zotit Çakaj.

Po zoti Çakaj, besoj që u ndërpretë për ndonjë problem teknik; jemi duke votuar nenin 4, “Përparësia në përzgjedhje”; 4 kolegët janë pro propozimit. Ju lutem, vota juaj!

**Zoti Muharrem Çakaj:** Jam dakord me projektaktin e paraqitur nga Komisioneri dhe Nënkomisionerja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve!

**Znj. Iliriana Nano:** Faleminderit, atëherë me 5 vota pro miratohet neni 4 i projektvendimit.

Kalojmë të neni 5, një fazë tjetër e procedurës, “Paraqitja e kërkesës”.

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi shpall publikisht thirrjen për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ofrojnë shërbimin si operatorë teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve në qendrën e votimit.
2. Thirrja publike sipas pikës 1 të këtij neni përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim për kandidatët për operatorë teknikë, si dhe mënyrën dhe afatet e aplikimit.
3. Aplikimi nga të interesuarit kryhet në faqen zyrtare të KQZ-së, në një rubrikë të veçantë të krijuar për këtë qëllim. Shtetasit e interesuar vetë-deklarojnë të dhënat e kërkuara për përmbushjen e kërkesave duke plotësuar fushat përkatëse dhe dërgojnë në rrugë elektronike në KQZ formatin e plotësuar.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*

4. Mos deklarimi i saktë i të dhënave ose deklarimi i rremë i tyre, sjell sipas rastit përgjegjësi penale ose administrative për aplikuesin.

Çelim diskutimin për këtë nen, për nenin 5!

Nëse dikush ka diçka, le të kërkojë fjalën, ju lutem!

Atëherë, shoh që nuk ka ndonjë koment apo propozim konkret. Kështu, që do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë për nenin 5 sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioneri dhe Nënkomisionerja.

***Kush është dakord me përmbajtjen ju lutem?!***

***Atëherë, me 5 vota pro miratohet neni 5.***

Kalojmë tek neni 6, “Procedurat e shqyrtimit të kërkesave”

Pika 1. Jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve, struktura përgjegjëse e administratës së KQZ-së, përgatit listën e shtetasve të cilët përmbushin kërkesat dhe kushtet për të qenë operatorë teknikë, sipas përcaktimeve të neneve 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Pika 2. Shtetasit e përzgjedhur sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni i nënshtrohen trajnimit dhe testimit të njohurive për shërbimin si operatorë teknikë.

Pika 3. Shtetasit e përzgjedhur sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, të cilët nuk marrin pjesë në trajnim apo nuk kalojnë testimin, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, nuk mund të caktohen si operatorë teknikë.

Pika 4. Procesi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni drejtohet, mbikëqyret dhe monitorohet nga Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Lidhur me nenin 6, ndonjë koment nga përfaqësuesit e partive politike apo anëtarët e rregullatorit?!

Nëse nuk kemi komente apo propozime, ju ftoj të votojmë nenin 6 sipas përmbajtjes së propozuar.

***Të nderuar kolegë, kush është dakord me nenin 6?***

***Zoti Çakaj, ...! ... deri tani kemi 4 vota pro!***

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*





***Kundër?!***

***Një votë kundër!***

***Atëherë me 4 vota pro dhe një votë kundër miratohet neni 6.***

Po zoti Çakaj, po?!

Nuk dëgjoheni! Ju lutem mikrofonin. Nuk dëgjoheni zoti Çakaj!

***Zoti Muharrem Çakaj:*** Atëherë për shkak të problemeve teknike nuk e ndjek dot në kohë reale mbledhjen dhe nëse ishim të neni 6, jam dakord me propozimin e komisionerit, por si duket kishte një kundër kohë, unë nuk jam kundër këtij propozimi.

***Znj. Iliriana Nano: Dakord, atëherë me 5 vota pro miratohet neni 6.***

Kalojmë tek neni 7, “Caktimi i operatorëve teknikë”.

1. Jo më vonë se 7 ditë para ditës së zgjedhjeve, komisioneri shtetëror i zgjedhjeve dhe nënkomisioneri caktojnë operatorët teknikë shtetasit e përzgjedhur sipas nenit 6 të këtij vendimi.
2. Në kontratën e shërbimit përcaktohet numri i qendrës së votimit ku shtetasi i përzgjedhur caktohet si operator.
3. KQZ-ja dhe shtetasi i përzgjedhur si operator nënshkruajnë kontratën përkatëse të shërbimit.
4. Nëse, për shkaqe të ndryshme, operatori teknik i caktuar nuk paraqitet për ofrimin e shërbimit, në vend të tij caktohet një person tjetër i cili është në listën e personave të përzgjedhur sipas nenit 6 të këtij vendimi.

Komente, propozime!

Atëherë, ...

Po, po zoti Sulo!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*

**Zoti Sh. Sulo:** Nëse më lejohet, në këtë pikë mendoj se duhet të shënohet edhe sanksioni për këtë person, meqenëse folëm pak më lart për sanksionet. A duhet të ketë sanksione në këtë pikë apo jo?!

**Znj. Iliriana Nano:** Kemi në nenin 9 tek “përgjegjësitë e operatoreve teknike”. Janë parashikuar përgjegjësitë civile ose penale.

**Zoti Sh. Sulo:** Dakord, dakord! Ndjesë!

**Znj. Iliriana Nano:** Ju lutem!

Atëherë kolegë, kemi ndonjë propozim për këtë nen apo të kalojmë për votim?

Ju ftoj për të votuar nenin 7!

Kush është dakord me propozimin e nenit 7 sipas përmbajtjes të ardhur nga Komisioneri? Zoti Çakaj, ndoshta jeni me vonesë!

**Me 5 vota pro miratohet neni 7.**

Kalojmë tek neni 8, “Detyrat e operatorit teknik”

Gjatë ditës së zgjedhjeve operatori teknik kryen këto detyra:

- a) Në orën 6 paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar me dokumentin personal të identifikimit, si dhe aktin e caktimit ose vërtetimin përkatës të pajisur nga KQZ-ja
- b) Para orës 7 të ditës së votimit, aktivizon pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve në prani të anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve. Dorëzon menjëherë tek anëtarët e KQV-së raportin që pajisja e identifikimit elektronik të zgjedhësve printon pas aktivizimit të saj.
- c) Gjatë zhvillimit të votimit:
  - i. Përdor pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve në përputhje me manualin teknik të përdorimit të saj.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

- ii. Informon anëtarët e KQV-së për veprimet që kryhen prej tij, si dhe për funksionalitetin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve.
- iii. Zbaton në çdo rast vendimin e KQV-së për autorizimin e kryerjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve për rastet e parashikuara në aktet e KQZ-së.
- iv. Dorëzon tek anëtari i KQV-së, çdo vërtetim të kryerjes së verifikimit të zgjedhësve të printuar nga pajisja e identifikimit elektronik PEI.
- v. Kryen menjëherë njoftimin në qendrën operacionale të asistencës teknike për çdo problem lidhur me funksionalitetin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve, PEI.
- vi. Zbaton me saktësi instruksionet e dhëna nga personeli i qendrës operacionale të asistencës teknike.
- vii. Dërgon në KQZ raportet periodike të prodhuar nga PEI mbi pjesëmarrjen në zgjedhje në atë qendër votimi.

ç) Në mbyllje të votimit:

- i. Zbaton vendimin e KQV-së për mbylljen e procesit të votimit.
- ii. Dorëzon menjëherë tek anëtarët e KQV-së raportin që pajisja e identifikimit elektronik të zgjedhësve printon pas mbylljes së procesit të identifikimit të zgjedhësve.
- iii. Nënshkruan procesverbalin e vulosjes së kutisë ku do të vendoset pajisja e identifikimit elektronik të zgjedhësve.

d) Njofton menjëherë KQZ-në për vendime apo veprime të KQV-së, të cilat bien ndesh me manualin e përdorimit të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe procedurat e përcaktuara me aktet e KQZ-së.

Atëherë është një nen shumë i detajuar në fakt, që përcakton detyrat e operatorit teknik gjatë ditës së votimit duke nisur që me orën 6 paradite, me veprimet që kryen para nisjes së votimit, gjatë zhvillimit të votimit dhe pas përfundimit të votimit

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



Të nderuar kolegë, të nderuar përfaqësues të partive politike, nëse keni diçka lidhur me këtë nen kaq të detajuar lidhur me detyrat e operatorit teknik gjatë ditës së zgjedhjeve?!

Po, po zoti Sulo!

**Zoti Sh. Sulo:** Zonja kryetare unë kisha merak te, ... mesa më kujtohet pika 5/1, momenti kur përfaqësuesi deklaroi që pajisja është gati apo jo për kryerjen e votimit. A mos ndoshta duhej shtuar që në momentin e fillimit të votimit pajisja të ketë një ... (shënim: nuk kujtohet asgjë nga ajo që thotë folësi, zoti Sulo)

**Znj. Iliriana Nano:** Zoti Sulo nuk ju dëgjojmë mirë.

**Zoti Sh. Sulo:** Personi duhet të deklarojë para komisionit që pajisja është gati, ... a nuk duhet shtuar pak që para fillimit të votimit pajisja është gati për votim, nuk ka probleme.

**Znj. Iliriana Nano:** Atëherë po ta lexojmë me vëmendje aktin ose nëse keni ndjekur eksperimentin e zhvilluar disa ditë më parë, ...

Atëherë, në pikën b, veprimi i parë para orës 7 është “aktivizon pajisjen” dhe e dyta “dorëzon raportin” që pajisja printon pas aktivizimit të saj.

Zonja Pelinku, ju mund të na thoni diçka më tepër për të adresuar shqetësimin e zotit Sulo lidhur me këtë proces teknik.

**Zonja Lealba Pelinku:** Po, pra, bëhet fjalë para se të fillojë procedura e votimit, operatori teknik, ... veprimet që bën konsiston në aktivizimin e pajisjes, pra e thënë me fjalë të thjeshta, komisioni, ka mundësi të verifikojë, pra me anë të operatorit, të veprimeve që ai kryen, që pajisja funksionon,...

**Znj.L.Pelinku:** Pra, pajisja bëhet gati për të çelur procedurën e votimit, procedurë e cila nuk mund të fillojë përpara orarit të vendosur orës 07:00. Pasi të jetë çelur procedura e votimit aktivizohet lista e asaj qendre votimi në pajisje dhe bëhet e mundur, fillimisht gjenerohet raporti i cili bën të mundur që të verifikohet që në orën 07:00 pra, në momentin e çeljes së procedurës 0 qytetarë zgjedhës janë identifikuar dhe më pas vijohet me identifikimin e radhës së zgjedhësit së radhës.

**Znj.I.Nano:** Zonja Pelinku faleminderit. Zoti Sulo nuk e di nëse jeni i qartë pas sqarimit që zonja Pelinku dha?

**Z.Sh.Sulo:** Po, zonja kryetare faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Atëherë jeni në kushte që do të bëni një propozim?

**Z.Sh.Sulo:** Jam dakord me sqarimin.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit!

Nëse nuk ka komente, pyetje apo propozime, unë do të ftoja kolegët për të votuar nenin 8 “Detyrat e operatorit teknik”.

Të nderuar kolegë,

**Kush është dakord me nenin 8 sipas përmbajtjes së propozuar?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

Miratohet neni 8.

Kalojmë te neni 9 “Përgjegjësitë e operatorëve teknik”

**Pika 1.** Operatori teknik ushtron përgjegjësitë dhe përmbush detyrat e tij në mënyrë të paanshme dhe në përputhje të plotë me aktet e KQZ-së.

**Pika 2.** Operatori teknik është përgjegjës vetëm për përdorimin teknik të **PEID** dhe respektimin e detyrave të caktuara në nenin 8 të këtij vendimi.

**Pika 3.** Operatori teknik nuk ka rol vendimmarrës në lidhje me të drejtën e zgjedhësit për të votuar ose jo.

**Pika 4.** Operatori teknik është përgjegjës për vënien në punë dhe përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve vetëm në qendrën e votimit ku është caktuar sipas manualit të përdorimit të saj dhe procedurave të përcaktuara në aktet e KQZ-së.

**Pika 5.** Operatori teknik nuk ka të drejtë të përgatisë ose dhe të administrojë dokumentacion apo material zgjedhor.

**Pika 6.** Gjatë ushtrimit të detyrës apo pas përfundimit të saj, nuk duhet të sigurojë, jap informacion apo bëj publike për partitë politike, mediat, organizatat të Shoqërisë Civile, të dhëna lidhur me ecurinë e procesit të identifikimit elektronik të zgjedhësve apo pjesmarrjen e zgjedhësve në votime.

**Pika 7.** Operatorët teknik mbajnë përgjegjësi civile ose penale për veprimet mosveprimet e tyre në kundërshtim me kontratën dhe ose legjislacionin penal në fuqi.

Kolegë çelim diskutimet për nenin 9 nëse ka ndonjë pyetje drejtuar komisionerit, nën komisioneres ndonjë koment apo nëse keni ndonjë propozim për shtesa ndryshime, ju lutem mund të merrni fjalën. Nuk keni. Të nderuar kolegë ju ftoj të votojmë nenin 9 të projektvendimit sipas përmbajtjes.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj. Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

Miratohet neni 9.

Kalojmë në nenin 10 "Ofrimi i shërbimit"

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**Pika 1.** Kontrata e shërbimit për punën e operatorit teknik për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve përcakton numrin dhe vendodhjen e qendrës së votimit ku operatori teknik është caktuar.

**Pika 2.** Kontrata e shërbimit parashikon edhe ndërprerjen e menjëherëshme të saj në rast se operatori teknik nuk realizon përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara në këtë vendim.

**Pika 3.** Operatorët teknik për shërbimin e ofruar përfitojnë shpërblim në masën 9 mijë lekë. KQZ mbulon shërbimet e transportit për rastet kur operatori teknik ofron shërbimin jo pranë vendbanimit të tij.

Atëherë çelim diskutimet për nenin 10, përfaqësuesit e partive politike së pari dhe më tej anëtarët e rregullatorit kanë ndonjë koment?

Nuk ka komente pyetje propozime.

Ftoj kolegët të votojmë nenin 10 të projektvendimit “Ofrimi i shërbimit”

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***

Miratohet neni 10.

Kalojmë në nenin 11 “Votimi i operatorëve teknik”. Operatorët teknik votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar për të ofruar shërbimin”.

Zoti Kaziaj duke qenë se më herët shfaqët një shqetësim, nuk e di nëse përmbatja e këtij neni ju duket korrekte apo keni ndonjë propozim për ta përmirësuar?

***Z.A.Kaziaj:*** Shumë korrekte zonja kryetare.

***Zni.I.Nano:*** Përfaqësuesit e partive të tjera politike kanë ndonjë koment lidhur me këtë çështje? Bëhet fjalë për të drejtën për të votuar më shumë se 5200 shtetasëve të cilët do të jenë në shërbim të KQZ-së dhe jo domosdoshmërisht

atë ditë pranë qendrës së votimit ku ata votojnë normalisht dhe ku janë të regjistruar. Kështu që është menduar në këtë rast ashtu si për anëtarët e KQV-së edhe për operatorët teknik të votojnë në qendrën ku janë caktuar. Ka komente, propozime? Nuk ka. Ju ftoj të votojmë nenin 11.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

Miratohet neni 11.

Atëherë neni 12 është hyrja në fuqi.

**Pika 1.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Pika 2.** Kundër këtij votimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Votojmë nenin 12.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

Miratohet neni 12.

Pasi kemi votuar në parim projektvendimin e kemi shqyrtuar dhe e kemi votuar nen për nen, është momenti të votojmë në tërësi projektvendimin.

***Të nderuar kolegë kush është dakord me projektvendimin në tërësi?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

Komisioni Rregullator me 5 vota pro sapo miratoi Projektvendimin “Për caktimin e personelit të kualifikuar për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrën e votimit”. Me këtë rast do të ftoja Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneren që në zbatim të këtij vendimi brenda 24 orëve nga ky moment ku sapo është miratuar vendimi, të bëjnë publik



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

njoftimin, shpalljen për shprehjen e interesit të të interesuarve të kandidatëve për operatorë teknikë. Unë ju falenderoj, nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët. Po zoti Kaso!

**Z.I.Kaso:** Faleminderit, zonja kryetare. Kam dicka jashtë rendit të ditës në vijim edhe të *email-eve* që i kemi drejtuar Rregullatorit, do të doja që të ripërsërisja me forcë kërkesën time për heqjen dorë nga praktika e zhvillimit të mbledhjeve *online*. Kjo jo vetëm për shkak të situatave të pakëndshme të evidentuara në mbledhjet e fundit edhe te kjo e sotmja ku është shumë e vështirë ndjekja e mbledhjes edhe ndjekja e materialit dhe jo më të krijohen hapësira dhe kushte për diskutime ose për zgjidhje konstruktive. Kështu që në kushtet kur Komisioni Rregullator është e vetmja pjesë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila ende vazhdon me një praktikë të tillë të pafrytshme në këndvështrimin tim dhe duke e konsideruar kohën e paktë që na mbetet deri për zgjedhje dhe karakterin dinamik që duhet të kenë në zgjedhje, e ripërsëris me forcë propozimin tim për zhvillimin e mbledhjeve fizike. Problemi i dytë që kisha është nevoja që pavarësisht se KQZ-ja sipas formatit të ri funksionon në 3 pjesë si Trinia e Shenjtë është po tre dhe një, pra janë tre pjesë, por të treja janë pjesë të KQZ-së, koordinojnë me njëra tjetrën, lidhur me kohën e zhvillimit të mbledhjeve që secila mbledhje të ketë kohën e nevojshme të zhvillimit të saj dhe të devotshëm i referohem përplasjes së pa këndshme të njoftimit tuaj për thirrjen e mbledhjes në orën 17:30, ndërkohë që Komisioneri kishte thirrur për mbledhje në orën 17:00, një mbledhje e cila u detyrua që të ezauronte pikat e rendit të ditës në mënyrë të shpejtë, thjesht dhe vetëm për të shtuar praninë në mbledhjen tuaj. Kështu që nuk kishte kuptim dhe në këtë këndvështrim zhvillimi i një mbledhje në ora 17:00 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe më pas një mbledhje tjetër virtuale në ora 17:30, ku personat që ishin në sallën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të gjenin një hapësirë në internet që të ishin në mënyrë

25

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.02.03.2021*

virtuale me ju. Aspak serioze kjo, duket se krijon....që partitë politike një prej të cilëve përfaqësoj unë të kenë aksesin e nevojshëm të domosdoshëm për të qenë prezent në të gjitha mbledhjet. Ne lidhemi duke qenë fizikisht në sallën e mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zonja kryetare do të kërkoja që të merreshin në konsideratë nga ana juaj dhe të adresohet.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaso faleminderit, patjetër që kjo çështje që ju sapo diskutuat që ngritet si shqetësim është gjithashtu shqetësim dhe nga ana jonë. E vetmja gjë që do të thoja është që nuk kemi *emaile* nga ana juaj drejtuar Komisionit Rregullator për zhvillimin e mbledhjeve live, megjithatë është një shqetësimi i yni që duke adresuar ne besoj se do ta zgjidhim duke e nisur nga mbledhja e ardhshme. Ju falenderoj për këtë shqetësim të ngritur dhe besoj se shumë shpejt nisur dhe nga ajo që thatë nga dinamika nga afrimi i ditës së zgjedhjeve, nga mbledhjet që do të zhvillohen me njoftime jo të largëta në kohë. Tashmë besoj se edhe kjo çështje do të marrë vëmendjen e duhur nga Komisioni Rregullator dhe besoj se do të zgjidhet në mbledhjet e ardhshme. Po zoti Sulo.

**Z.Sh.Sulo:** Jam dakord me shqetësimin e kolegut zonja kryetare doja të shprehja dhe unë shqetësimin nuk është e vërtetë që kanë munguar *emailet* për të kryer seancat *live* kanë qenë disa, personalisht unë kam qenë personi që kam bërë disa herë që seancat të kryhen *live*. Është absurde që regjistrimi i Partisë Komuniste e cila u bë si tabu doli në media pse nuk u regjistrua Partia e Punës u bë shumë e madhe nga ana e komisionit, ndërsa për një akt i cili ishte shumë konkret shumë i rëndësishëm sot u bë *online*. Pra unë do të kërkoja zonja kryetare që mbledhjet këtej e tutje të zhvilloheshin fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke respektuar të gjitha masat e Covidit.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**Znj.I.Nano:** Bashkohem me shqetësimin tuaj ndërkohë më lejoni të deklaroj nën përgjegjësinë time personale unë si Kryetare e Komisionit Rregullator nuk kam asnjë *email* nga asnjë përfaqësues i partive politike. Gjithësesi shqetësimi juaj është i drejtë dhe sikundër i thashë zotit Kaso, Komisioni Rregullator do ta vlerësojë që mbledhjet në vijim të zhvillohen në sallën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zoti Kaziaj i bashkoheni të njëjtit shqetësim apo keni diçka tjetër?

**Z.A.Kaziaj:** Patjetër që ne ndajmë të njëjtin shqetësim, do të ishte e udhës që brenda rregullave të parandalimit të përhapjes së Covidit të zhvilloheshin fizikisht pranë institucionit të KQZ-së. Pavarësisht për pjesën e komunikimit jo në kohë dhe komunikimit të ndryshuar të themi në momentin e fundit nga ana juaj gjithësesi këtë gjë e mirëkuptojmë nuk mendojmë se është bërë qëllimisht se nuk ka sens. Ne çmojmë që nga mbledhja e ardhshme ashtu siç po bëhen mbledhjet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ashtu dhe Rregullatori t'i bëjë mbledhjet pranë KQZ-së në një seancë publike.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Kaziaj, faleminderit përfaqësuesve të partive politike, anëtarëve të Komisionit Rregullator, Komisionerit, administratës së KQZ-së. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur duke e adresuar në vijim shqetësimin e paraqitur.

**Vendimi nr. 7**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*

